



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

**“PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PAGESËN NGA REZERVA
MONETARE TË DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATAT E SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM MOTORIK NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”**

Miraturar me vendimin e Bordit nr. 18, datë 10.03.2014

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të krijimit, llogaritjes, financimit, raportimit dhe monitorimit të rezervës monetare për kryerjen e pagesave të dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e procedurave për stabilizimin dhe përmirësimin e sistemit të dëmshpërblimit për dëmet, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, për të garantuar mbrojtjen e të siguruarve, kryerjen me korrektësi të procedurave të dëmshpërblimit dhe qëndrueshmërinë e shoqërive të sigurimit.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, paragrafët 3 dhe 20 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 13 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe nenit 104, paragrafi 3 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen ndaj shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, që ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Neni 5

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“rezervë monetare” - është rezerva që krijohet për të paguar dëmet, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit;

“rezervë monetare fillestare” - është shuma e rezervës monetare që krijohet njëherë në fillim dhe që ndryshohet më pas në përputhje me ecurinë e primeve të rrezikut dhe të pagesave të dëmeve;

“rezervë monetare mujore” - është pjesa e primeve të rrezikut të mbajtur si rezervë monetare dhe që i shtohet gjendjes në fillim të muajit të rezervës monetare;

“llogari të tjera qëllimore” - janë llogari bankare të shoqërive të sigurimit që përdoren vetëm për të kryer pagesat e dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit;

“primi i rrezikut” - është primi sipas përcaktimit të Rregullores nr. 110, datë 28.07.2011, “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”, e ndryshuar.

PJESA II

KRIJIMI DHE LLOGARITJA

Neni 6

Krijimi i rezervës monetare

1. Shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervën monetare fillestare në nivelin 20% të primit të rrezikut të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, të nënshkruara nga shoqëritë e sigurimit për periudhën 1 Maj 2013 deri në 30 prill 2014.
2. Shoqëritë e sigurimit financojnë çdo muaj rezervën monetare, duke e shtuar atë me nivelin 30% të primit të rrezikut të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, të nënshkruara nga shoqëritë e sigurimit, në atë muaj.

Neni 7

Llogaritja e rezervës monetare

1. Shoqëritë e sigurimit llogarisin rezervën monetare në fillim të çdo muaji, duke i shtuar gjendjes në fillim të muajit rezervën monetare mujore, sipas përcaktimit në nenin 6.2 të kësaj rregulloreje, dhe duke i zbritur shumën e dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, të paguara në atë muaj. Përfundimisht nga ky rregull, në rastet kur kjo shumë e dëmeve të paguara në atë muaj është më e madhe sesa gjendja e rezervës monetare mujore në të njëjtin muaj të një viti më parë, atëherë gjendjes në fillim të muajit të rezervës monetare të shtuar me rezervën monetare mujore, i zbritet gjendja e rezervës monetare në të njëjtin muaj të një viti më parë.
2. Gjendja në fund të çdo muaji e rezervës monetare në asnjë rast nuk do të jetë më e vogël sesa 90% e gjendjes në fillim të po atij muaji të rezervës monetare.

3. Shoqëritë e sigurimit, për qëllime të llogaritjes së rezervës monetare, trajtojnë si dëme të paguara gjatë muajit, si më poshtë:
 - a. Dëme të paguara bruto gjatë muajit, në rast se këto dëme lidhen me polica të raportuara në regjistrin e shitjeve online të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe këto pagesa janë të raportuara të paguara rregullisht;
 - b. Dëme të paguara bruto gjatë muajve të mëparshëm, në rast se pagesat e këtyre dëmeve janë raportuar në regjistrin e shitjeve online të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe këto pagesa janë të raportuara të paguara në muajin aktual.

Neni 8

Mbajtja e rezervës monetare

- 1 Shoqëritë e sigurimit mbajnë rezervën monetare në llogaritë e veçanta qëllimore, pranë bankave që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
- 2 Llogaritë bankare qëllimore të hapura sipas pikës 8.1 të këtij neni emërtohen si në vijim: “Shoqëria e sigurimit (emri i shoqërisë) - rezervë monetare.”

PJESA III

RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Neni 9

Pagesat e dëmeve

1. Pagesat e dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, kryhen vetëm nëpërmjet llogarive qëllimore pranë bankave që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të krijuara për pagesën e këtyre dëmeve apo nga llogaritë bankare qëllimore të rezervës monetare.

2. Pagesat e dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, të kryera gjatë muajit për të cilin llogaritet rezerva monetare, merren parasysh nga shoqëritë e sigurimit në përcaktimin e gjendjes në fund të muajit të rezervës monetare, vetëm nëse ato janë kryer nëpërmjet llogarive bankare qëllimore, pavarësisht burimit të financimit të përdorur për to.

Neni 10

Raportimi i rezervës monetare

Shoqëritë e sigurimit raportojnë çdo muaj në Autoritet, brenda datës 10 të muajit pasardhës, si më poshtë:

1. Dëmet e paguara gjatë muajit, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit;
2. Gjendjen në fillim dhe në fund të muajit të rezervës monetare;
3. Nxjerrjet e llogarive bankare për gjendjen në fund të muajit për llogaritë e tjera qëllimore.

Neni 11

Raportimi i transaksioneve bankare

Shoqëritë e sigurimit raportojnë transaksionet bankare lidhur me pagesën e dëmeve, që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, të kryera nëpërmjet llogarive qëllimore me specifikimet e mëposhtme:

1. Numrin e dosjes së dëmit, për të cilin kryhet pagesa;
2. Emrin e përfituesit të dëmshpërblimit;
3. Bankën dhe numrin e llogarisë bankare të përfituesit të dëmshpërblimit.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 12

Afati për krijimin e rezervës monetare fillestare

1. Shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervën monetare fillestare brenda datës 2 Maj 2014.
2. Shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet llogaritjen dhe krijimin, sipas elementeve të përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregulloreje, si dhe shumën e rezervës monetare fillestare brenda datës 5 Maj 2014.
3. Pjesë e kësaj rregulloreje janë edhe shtojcat 1 dhe 2.

Neni 13

Mosrespektimi i dispozitave të rregullores

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje përbën shkelje dhe trajtohet sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurimeve dhe risigurime”.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Enkeleda SHEHI

KRYETAR

Shtojca 1: Krijimi i rezervës monetare fillestare

Shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervën monetare fillestare në bazë të nenit 6.1 të kësaj rregulloreje. Llogaritja e shumës së rezervës monetare fillestare bëhet duke u bazuar në shumën e primit të rrezikut për çdo muaj për periudhën 1 maj 2013 - 30 prill 2014 dhe nivelin prej 20% kundrejt shumës së primit të rrezikut. Shuma gjithsej e rezervës monetare fillestare, që do të depozitohet në llogarinë bankare qëllimore të shoqërisë, është sa totali i rezervës monetare mujore të llogaritur sipas shembullit në vijim:

Nr	Muaji	Primet e rrezikut (milionë lekë)	Pjesa që mbahet si rezervë monetare	Shuma mujore e rezervës monetare (milionë lekë)
1	Maj 2013	20	20%	4
2	Qershor 2013	30	20%	6
3	Korrik 2013	20	20%	4
4	Gusht 2013	30	20%	6
5	Shtator 2013	20	20%	4
6	Tetor 2013	30	20%	6
7	Nëntor 2013	20	20%	4
8	Dhjetor 2013	30	20%	6
9	Janar 2014	20	20%	4
10	Shkurt 2014	30	20%	6
11	Mars 2014	20	20%	4
12	Prill 2014	30	20%	6
Shuma e rezervës monetare fillestare për t'u depozituar në llogarinë bankare qëllimore brenda datës 5 maj 2014				60

Shtojca 2: Mbajtja e rezervës monetare

Shoqëritë e sigurimit mbajnë rezervën monetare në bazë të nenit 6.2 të kësaj Rregulloreje. Llogaritja e shumës së rezervës monetare në fund të muajit bëhet sipas formulës në vijim:

Gjendja në fund të muajit aktual e rezervës monetare	=
Gjendja në fillim të muajit aktual e rezervës monetare	+
Shuma e rezervës monetare mujore (30% x primet e rrezikut)	-
Shumën më të vogël ndërmjet dëmeve të paguara gjatë muajit ose rezervës monetare të të njëjtit muaj nga viti i kaluar	

Shuma në fund të muajit e rezervës monetare, që do të depozitohet në llogarinë bankare qëllimore të shoqërisë, llogaritet sipas shembullit në vijim:

Muaji	Primet e riskut (milionë lekë)	Gjendja në fillim të muajit e rezervës monetare (milionë lekë)	Shuma e rezervën monetare mujore (milionë lekë)	Dëmet e paguara gjatë muajit (milionë lekë)	Gjendja në fund të muajit e rezervës monetare (milionë lekë)
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5) = (2) + (3) – (4)
Janar 2014	10	40	3 (10 x 30%)	4	39
Shkurt 2014	39				

Në rastin kur rezerva monetare mujore e të njëjtit muaj të vitit të kaluar është më shumë sesa rezerva monetare mujore e muajit aktual, atëherë gjendja në fund të muajit e rezervës monetare llogaritet si më poshtë:

Nr	Elementët	Shuma (milionë lekë)
1	Volumi mujor i primeve të rrezikut për muajin aktual	10
2	Gjendja në fillim të muajit e rezervës monetare	40
3	Rezerva monetare mujore e muajit aktual (1 x 30%)	3
4	Dëmet e paguara gjatë muajit	4
5	Rezerva monetare mujore e të njëjtit muaj në vitin e kaluar	2
6	Minimumi ndërmjet (4) dhe (5)	2
7	Gjendja në fund të muajit e rezervës monetare = (2) + (3) – (6)	41

Në kuptimin e nenit 7.2 të rregullores, në rast se gjendja në fund të muajit e rezervës monetare rezulton për shembull 42 milionë lekë, kur gjendja në fillim të muajit e rezervës monetare është 50 milionë lekë, atëherë gjendja për t'u financuar në fund të muajit aktual nga shoqëritë është jo më pak sesa 45 milionë lekë (90% x gjendja në fillim të muajit).